



REPUB{...} E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 144, datë 19.03.2024

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT NË PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE
NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 252 DATË
24.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR KANDIDATËT QË NUK
KANË DHE NUK MUND TË KENË ASNJË VLERËSIM**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IV dhe V të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, më propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.
2. Për kandidaten znj. {...}, e cila ka kandiduar në procedurat e lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, procedura e verifikimit të kriterëve ligjore që ka përfunduar për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për lëvizjen paralele, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR